



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 5826 / Pro  
1

Tiranë, 11.03 2024

Lënda: Dërgim Udhëzimi

TË GJITHË OPERATORËVE POSTAR  
TË GJITHË DEGËVE DOGANORE  
TË GJITHË DEPARTAMENËVE NË DPD

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim udhëzimin Nr. 02 datë 11.03.2024  
"Deklarimi i parambërritjes/paranisjes dhe procedura të thjeshtuara për mallrat që importohen/eksportohen nëpërmjet postës së shpejtë".

Degët doganore të marrin të gjitha masat për njohje dhe zbatim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 5826 Prot.

Tiranë, më 11/3/2024

UDHËZIM

Nr. 02 datë 11/3/2024

**“Deklarimi i parambërritjes/paranisjes dhe procedura të thjeshtuara për mallrat që importohen/eksportohen nëpërmjet postës së shpejtë”**

Mbështetur në nenet 10, 48, 52, 84 - 93, 101-106, 119 deri 140, 146 deri 155, 184, 188, 203 dhe 204 të Ligjit 102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, dhe në nenet 1, 160, 179 deri 194, 234 deri 242, 246 deri 258, 303 deri 329, 356 deri 362, 420 deri 424, 606, 607, dhe 725 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

Bazuar në 737 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, si dhe pikën 1 (b)(i) të Pjesës VIII/1 të Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për Personelin e Administratës Doganore- i ndryshuar”;

Me qëllim lehtësimin, standartizimin dhe analizën e riskut para mbërritjes ose paranisjes së mallrave në/nga territori doganor shqiptar;

UDHËZON

**1. PËRKUFIZIME**

Për qëllim të këtij udhëzimi.

1.1 **“Dërgesë e postare”** konsiderohen mallrat, përveç artikujve të korrespondencës, të përfshira në një pako ose paketë postare të përcjellë nën përgjegjësinë ose përmes një operatori postar.

- 1.2 **“Blerje on-line”** konsiderohet transaksioni nëpërmjet të cilit, mallrat që blihen (porositen) në internet nga një person importohen përmes dërgesave postare.
- 1.3 **“Operator Postar”** konsiderohet një operator i licensuar, i vendosur në Republikën e Shqipërisë që ofron shërbime ndërkombëtare të rregulluara nga Konventa Universale Postare.
- 1.4 **“Artikuj korrespondence”** janë, letrat, kartolinat, letrat me shkrim për të verbërit si dhe materiale të shtypura/të printuara që nuk i nënshtrohen detyrimit të importit ose eksportit.
- 1.5 **“Kufiri i vlerës së papërfillshme”** quhet kufiri i vlerës së një malli mbi të cilën duhet të paguhet detyrimet e importit.
- 1.6 **Deklarata përmbledhëse e parambërritjes/e paranisjes** për dërgesat e shpejta – deklaratë me të dhëna të reduktuara që duhet të depozitohet në sistemin informatik të doganës në afatet e përcaktuara në VKM nr. 651, datë 10.11.2017 (neni 237 dhe 695).
- 1.7 **Deklaratë e thjeshtuar** është deklarata doganore me të dhëna të reduktuara (DAV) e cila depozitohet në sistemin informatik doganor për vendosjen e mallrave – dërgesa postare në një regjim doganor.
- 1.8 **“Përfaqësues”**, është punonjësi i Operatorit Postar, i licensuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të kryer deklarinimin e mallrave si dërgesa postare.
- 1.9 **“Zyrë doganore e hyrjes”**, zyra doganore, e cila është kompetente për mbikëqyrjen doganore në vendin ku mjetet e transportit, që transportojnë mallin, arrijnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga një territor jashtë këtij territori.
- 1.10 **“Zyre doganore mbikqyrese”** konsiderohet zyra doganore nën kompetencën territoriale të së cilës gjenden ambientet e Magazinimit të Përkohshëm që administrohen nga Operatori Postar.

## 2. PROCEDURA TË PËRGJITHSHME

2.1 Për të mundësuar lehtësimin e procedurave doganore lidhur me dërgesat e postës së shpejtë, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, hyn në zbatim deklarimi i parambërritjes/paranisjes për postën e shpejtë. Ky deklarim do të bëjë të mundur kryerjen e analizës së riskut para mbërritjes/paranisjes së ngarkesës, si rrjedhojë një kategori e përcaktuar dërgesash do të çlirohen menjëherë.

2.2 Si deklarim i parambërritjes/paranisjes do të përdoret manifesti, i cili do të depozitohet në sistemin informatik të doganës në momentin e nisjes së mjetit të transportit nga vëndi nisës sipas afateve të përcaktuara në nenin 237 dhe 695 të VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017.

2.3 Dërgesat postare që gjenden në një ngarkesë klasifikohen sipas kategorive të mëposhtme:

**Kategoria I-** janë “artikujt e korrespondencës”, që përfshijnë letrat, kartolinat, letrat me shkrim për të verbërit si dhe materiale të shtypura/të printuara që nuk i nënshtrohen detyrimit të importit ose eksportit.

**Kategoria II-** janë dërgesat me mallra të natyrës jo tregëtare të blera on-line nga individë për qëllime personale vlera e të cilave nuk e kalon kufirin e vlerës ekuivalente me 22 Euro, si dhe dërgesat postare të dërguara nga një individ jashtë territorit shqiptar për një individ rezident në këtë territor, vlera e të cilave nuk e kalon kufirin e vlerës ekuivalente me 45 Euro. Në eksport janë të gjithë dërgesat vlera e të cilave është nën vlerën ekuivalente me 1000 Euro.

Për mallra me vlerë nën kufijtë e përcaktuara si vlerë e papërfillshme, deklarimi doganor për vendosjen e tyre në një regjim doganor nga agjenti postar konsiderohet i depozituar (i bërë gojarisht), sipas nenit 146, pika 2 e Kodit Doganor dhe nenit 304, pika 1/a,b të Dispozitave Zbatuese.

**Kategoria e III-** janë të gjitha dërgesat postare në import vlera e të cilave është:

- a) Mallra të natyrës jo tregëtare:
  - mbi vlerën ekuivalente me 22 Euro për blerjet on line,
  - mbi vlerën ekuivalente 45 Euro për dërgesa postare dhe
  - nën vlerën ekuivalente me 1000 Euro.
- b) Mallra të natyrës tregëtare vlera e të cilave është nën vlerën ekuivalente me 1000 Euro.

Deklarimi i dërgesave (pakove postare) për mallrat që kanë vlerë brënda kufijve të përcaktuar në Kategorinë III, do të bëhet nëpërmjet deklaratës së thjeshtuar në sistemin kompjuterik doganor (neni 152-153 i Kodit Doganor, neni 316 i VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017). Për këtë kategori mallrash nuk do të depozitohet deklaratë plotësuese (pika 2,3 e nenit 153 të Kodit Doganor).

**Kategoria e IV-** janë të gjitha dërgesat postare në import dhe eksport vlera e të cilave është mbi vlerën ekuivalente 1000 Euro.

Mallrat e Kategorisë IV do të vendosen në regjim doganor duke depozituar deklaratë standarte (neni 149-150 i Kodit Doganor).

2.4 Personat juridik të licënuar si operatorët postar, të cilët do të përdorin procedurën e thjeshtuar për postën e shpejtë do të pajisen me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Operatorët postar

autorizohen pasi plotësojnë disa kriteret. Operatorët postar që nuk janë të autorizuar për këtë procedurë do të zbatojnë procedurën normale.

### **3. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË OPERATORËT POSTAR**

#### **3.1 Kushtet**

Autorizimi për të përdorur procedurën e thjeshtuar për postën e shpejtë u jepet *personave që plotësojnë kushtet* e mëposhtme:

- a) janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) japin sigurinë e nevojshme për funksionimin e duhur të operacioneve (neni 41/a i Kodit).
- c) të disponojë autorizim për magazinim të përkohshëm të mallrave;
- d) të disponojë sistemin informatik për rregjistrimet e dërgesave postare (me të dhënat e përcaktuara të deklarimit të parambërritjes/paranisjes), të cilat mund të transferohen në mënyrë automatike në sistemin informatik të doganës.
- e) Të lejojë autoritetet doganore në çdo kohë të kenë akses fizik dhe elektronik në dokumentacionin dhe të dhënat doganore, për qëllime kontrolli.
- f) Të sigurojë që punonjësit të informojnë autoritetet doganore sa herë që hasin vështirësi në zbatimin e legjislacionit doganor. Për këtë duhet të disponojnë dokument në formë rregulloreje me procedura për informimin e autoriteteve doganore për vështirësi të tilla.

Një Operator Ekonomik i Autorizuar i plotëson kushtet e pikës “b” dhe “f”.

#### **3.2 Aplikimi**

Aplikimi paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës. Aplikimi do të jetë sipas formatit në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aplikimi duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

- Autorizim ose Liçensë për ushtrimin e aktivitetit si “Postë e shpejtë”;
- Autorizim për Magazinim të Përkohshëm të Mallrave;
- Liçensë për ushtrimin e aktivitetit si agjensi doganore;
- Listën e personelit që do të ketë akses në sistemin informatik të doganës për kryerjen e procedurës.

#### **3.3 Refuzimi i aplikimit, miratimi**

Lidhur me aplikimin autoriteti doganor zbaton rregullat e përgjithshme për vendimet që merren bazuar në aplikime, të përcaktuara në nenet 27 – 34 të Kodit Doganor dhe nenet 14 – 32, të VKM nr.651, datë 10.11.2017.

- a) *Aplikimi refuzohet* në rastet e mëposhtme:
- Aplikimi është i pasaktë dhe/ose i paplotë;
  - Operatori ekonomik nuk plotëson një nga kushtet e parashikuara në pikën 3.1;
  - mungon një nga dokumentat që duhen bashkëlidhur aplikimit.
- b) Nëse aplikimi dhe dokumentacioni janë në rregull miratohet autorizimi, i cili do të jetë sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.

#### **4. PROCEDURAT DOGANORE**

4.1 Operatori postar njofton nëpërmjet adresës së përcaktuar nga autoritetet doganore mbi orarin e nisjes/mbërritjes së mjetit të transportit ajror, në varësi të orareve të lëvizjes së tyre.

4.2 Manifesti do të depozitohet në sistemin informatik të doganës në momentin e nisjes së mjetit ajror nga vëndi nisës, sipas përcaktimeve në nenet 237 dhe 695 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017. Të dhënat e manifestit duhet të jenë në përputhje me ato të parashikuara në Aneksin B, Shtojca A të VKM nr.651, datë 10.11.2017.

4.3 Sistemi bën selektimin e dërgesave në bazë të kategorive të përcaktuara sipas vlerës së mallrave në dërgesa dhe analizën e riskut. Gjithashtu, punonjësi doganor kryen verifikimet e duhura të dërgesave në një manifest dhe mund të përzgjedhë dërgesa për kontroll fizik pavarësisht se janë kryer nga sistemi.

4.4 Me mbërritjen e mjetit dhe shkarkimin e dërgesave, kryhet kontrolli i tyre dhe mbahen për kontroll fizik dërgesat e selektuara. Pjesa tjetër e dërgesave ngarkohen në mjetin e transportit, i cili plumboset dhe transferohen në ambjentet e magazinimit të përkohshëm të miratuara.

4.5 Lëvizja e mallrave nga ambjentet e magazinimit të përkohshëm të doganës hyrëse në ambjentet e magazinimit të përkohshëm të Operatorit Postar, bëhet nën përgjegjësinë e këtij të fundit në përputhje me nenin 256 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

4.6 Dërgesat e Kategorisë I dhe Kategorisë II çlirohen menjëherë, duke u konsideruar se mallrat janë vendosur në një regjim doganor.

4.7 Dërgesat e kategorisë III vendosen në regjim doganor duke përdorur deklaratën e thjeshtuar. Për çdo rast të lindjes së borxhit doganor, për shlyerjen e detyrimit të importit do të preket garancia.

4.8 Dërgesat e Kategorisë IV, si dhe mallrat që kushtëzohen nga masa ndaluese apo kufizuese, apo mallra, importi ose eksporti i të cilave kërkon leje të veçanta, do të ndiqet procedurat standarte të



deklarimit. Gjithashtu dhe në rastet e paraqitura në pikën 5 të këtij udhëzimi, do të ndiqet procedura standarte e deklarimit.

## 5. RASTET PËRJASHTIMORE TË PËRDORIMIT TË DEKLARATËS SË THJESHTUAR.

Nuk lejohet të deklarohen me deklaratë e thjeshtuar mallrat e Kategorisë III si më poshtë:

- Për blerjet on-line, mallrat e përcaktuara në nenin 421 të Dispozitave Zbatuese (produktet alkolike, parfumet dhe ujë tualeti, duhani dhe produktet e duhanit).
- Për dërgesat postare nga një individ rezident jashtë territorit shqiptar në një individ brenda këtij territori, me vlerë nën kufirin e papërfillshëm të vlerës së pataksueshme dhe sasia është mbi kufirin e përcaktuar në nenin 424 të VKM nr. 651 datë 10.11.2017. Lista e këtyre produkteve dhe sasi të perkatëse janë të paraqitura në aneksin 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
- Dërgesat (pakot postare) që kanë vlerë mbi vlerën ekuivalente me 1000 Euro
- Mallrat e natyrës tregëtare (Kategoria e III) që janë mallra akcize, si dhe mallrat për të cilat kërkohen leje/autorizime specifike (ndalimet/kufizimet).

Për rastet e paraqitura me sipër deklarimi do të kryhet nëpërmjet deklaratës doganore standarte.

Në zbatim të këtij udhëzimi do të miratohet dhe manuali i përdorimit lidhur me veprimet që do të kryhen në sistemin informatik.

Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen të gjithë zyrat doganore në të cilat do të kryhen deklarime për mallrat e hyra përmes postave të shpejta.

Ky Udhëzim hyn në fuqi më datë 11/03/2024 dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në rubriken Hyrja dhe dalja e mallrave (dogana.gov.al).

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**

**GENTI GAZHELI**



## ANEKS 1

### Aplikimi për procedurën e thjeshtuar për postën e shpejtë


<b>1. Aplikuesi</b>	Rezervuar për qëllime doganore
<b>2. Statusi ligjor i aplikuesit:</b>	<b>3. NIPT:</b>
<b>4. Adresa e selisë kryesore të aplikuesi:</b>	
<b>5. Vendndodhja e ambjenteve ku magazinohen dërgesat postare (adresa dhe kodi magazinës)</b>	
<b>6. Personi i kontaktit (emri, telefoni, e-mail)</b>	<b>7. Adresa e korrespondencës</b>
<b>8. Zyra doganore e hyrjes</b>	<b>9. Zyrat doganore mbikqyrëse:</b>
<b>10. Deklaratë:</b> Me paraqitjen e aplikimit ne pranojmë se lejojmë autoritet doganore të kenë akses të pakufizuar në të gjithë dokumentat dhe regjistrimet me qëllim kontrollin e mallrave dhe procedurave, si dhe tu ofrojnë atyre ndihmën e nevojshme. <input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO	
<b>11. Informacion lidhur me garantimin e detyrimeve të importit për sigurimin e borxhit doganor:</b>	
<b>12. Mënyra e njoftimit të zyrës mbikqyrëse kur dërgesa është jashtë orarit zyrtar (e-mail, tel, etj)</b>	
13. Administratori: ..... Emri: ..... Nënshkrimi..... Data: .....	



SHËNIME SHPJEGUESE  
(për aneksin I)

1.       **Aplikuesi:**  
Shënoni emrin e plotë të operatorit ekonomik aplikues.
2.       **Statusi ligjor i aplikuesit:**  
Shënoni statusin ligjor, siç përmendet në dokumentin e themelimit.
3.       **Numri NIPT:**  
Shënoni NIPT-in.
4.       **Adresa e vendit ku ka selinë kryesore aplikuesi (operatori ekonomik):**  
Shënoni adresën e plotë të vendit ku biznesi juaj është themeluar.
5.       **Vendndodhja e e ambjenteve ku magazinohen dërgesat postare**  
Shënoni adresën e plotë të ambjenteve të magazinimit të përkohshëm ku përpunohen dërgesat postare.
6.       **Personi i kontaktit:**  
Shënoni emrin e plotë, numrat e telefonit, faksit dhe adresën e e-mail-it të personit të kontaktit të caktuar nga ju brenda kompanisë suaj, për t'u kontaktuar nga autoritetet doganore kur shqyrtojnë aplikimin.
7.       **Adresa e korrespondencës:**  
Plotësojeni vetëm kur keni adresë tjetër të ndryshme nga kryesorja dhe e ambjenteve të përpunimit.
8.       **Zyrat doganore hyrjes:**  
Shënoni zyrat doganore ku hyjnë mallrat
9.       **Zyrat doganore mbikqyrjes:**  
Shënoni emrin e zyrës doganore mbikqyrëse të ambjenteve të magazinimit të përkohshëm.
10.      **Deklaratë:** Shenoni me PO nëse konfirmoni deklaratën.
11.      **Informacion lidhur me garantimin e detyrimeve të importit për sigurimin e borxhit doganor:**  
Jep informacion lidhur me të dhënat mbi garancinë bankare që do të mbulojë borxhin doganor.

## ANEKSI 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Autorizim nr....., datë.....

Bazuar në ligjin Ligjit 102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Udhëzimin nr....., datë..... “Mbi zbatimin e procedurave të thjeshtuara për mallrat që importohen/eksportohen nëpërmjet postës së shpejtë”, miratohet:

Autorizimi i përdorimit procedurës së thjeshtuar duke përdorur deklarin e parambërritjes për Operatorin Postar ....., NIPT .....

Adresa: .....

Informacion mbi personi/at përgjegjës (emer, e-mail, tel).....

Informacioni mbi ambientet e magazinimit të përkohshëm (kodi, adresa):.....

Afatet për depozitimin e deklaratës së parambërritjes/paranisjes:.....

Deklarimi i thjeshtuar i mallrave sipas kategorive:.....

Mbulimi i borxhit doganor (te dhënat mbi referencat).....

Adresa për njoftimit e deklaratës së parambërritjes/paranisjes (e-mail).....

Dega doganore mbikqyrëse: .....

**Drejtor i Përgjithshëm i Doganave**

## ANEKSI 3

### 1. Neni 421(VKM 651, datë 10.11.2017): Mallrat për të cilat nuk jepen përjashtime

Përjashtimi sipas nenit 420 të VKM 651, datë 10.11.2017 janë nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme:

- a) produktet alkoolike;
- b) parfimet dhe ujë tualeti;
- c) duhanet dhe produktet e duhanit.

### 2. Neni 424 (VKM 651, datë 10.11.2017): Kufizime

Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 422, duhet të kufizohet, për dërgesë, në sasi të dhëna për çdo mall të listuar si më poshtë:

- a) produkte të duhanit:
  - 50 cigare,
  - 25 cigarillos (puro e hollë e vogël me peshë maksimale deri në tri gramë secila),
  - 10 cigare puro,
  - 50 gramë duhan për tymosje, ose
  - një përzgjedhje proporcionale nga këto produkte të ndryshme;
- b) alkool dhe pije alkoolike:
  - pije të distiluara dhe pije alkoolike me përbërje alkooli mbi 22% të vëllimit; etil alkool jo i denaturuar me vëllim 80% e më tepër: 1 liter, ose
  - pije të distiluara dhe pije alkoolike, si dhe aperitivë me bazë vere apo alkooli, rum, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli që nuk kalon 22% të vëllimit; verëra me gaz, verëra likerit: një litër apo një përzierje proporcionale nga këto produkte të ndryshme, dhe
  - verë e pa gazuar: dy litra;
- c) parfume:
  - 50 gram, ose
  - ujëra tualeti: 0,25 litra.